

**URDHËR**  
**Nr. 25, datë 8.1.2018**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE TË SIGURISË PORTUALE NË TERMINALIN VLORA-1 (PIA)”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare, “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947””, dhe të nenit 5, pika “b”, të ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Terminalin Vlora-1 (PIA)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Terminali Vlora-1 (PIA) për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.
4. Urdhri nr. 2, datë 28.2.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Terminalin Vlora-1 (PIA)”, shfuqizohet.  
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
Damian Gjiknuri**